


BASHKIA MALËSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Koplik, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr 41 datë 30 / 06 / 2020

Per disa ndryshime në Vendimin nr.27,datë,30.04.2020 të Keshillit Bashkiak Malësi e Madhe : “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së shtetasit z.Vasel Kalaj.

Baza ligjore

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 30.06.2020, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 date 15.03.2020 neni 5

Si dhe rregullorja e Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe Nr.17 datë 30.04.2020 Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe

Në mbështetje të nenit 19,29 si dhe të nenit 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Në mbështetje të Ligjit nr.45/2019 datë, 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” .

Në mbështetje të Kreu III pika 1,gërma “ dh” si dhe të Kreu III pika 2,gërma “ ç” të VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” .

Në mbështetje të Udhëzimit të përbashkët nr.263 datë 24/5/2013 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare përmbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”Kreu III – të.

Si dhe në mbështetje të shkresës nr.341/1prot,datë ,18.05,2020 të Prefektit të Qarkut Shkoder,protokolluar me tonën nr.1105/36prot.,datë,20.05.2020,propozojmë /relatojmë miratimin e VKB

nr.27,datë,30.04.2020,sipas relacionit me ndryshimet/korigjimet përkatëse konstatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur vendimit,si dhe mbështetur në shkresën nr.341/3 prot.datë,22.06.2020 të Prefektit të Qarkut Shkodër,protokolluar me tonën nr.757/6,datë 26.06.2020.

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Vendimit nr.27 datë ,30.04.2020 të Keshillit të Bashkisë Malësi e Madhe “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të shtetasit z.Vasel Kalaj ,Për dhënien e ndihmës së menjëherëshme financiare nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, familjes së shtetasit z.Vasel Kalaj, të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore,banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë zjarrit të rënë në banesë dhe e djegjes së pjesshme.

Kërkesa,mbështetur në dokumentacionin tekniko-ligjor bashkëngjitur si më poshtë në vijim:

Bashkëlidhur VKB nr.27, datë, 30.04.2020, Preventivi për vlerësimin e dëmit nga ana ndërtimore dhe vlera e cituar në pikën 7 të VKB nr.27, datë, 30.04.2020 në shumën 1.027.481 lekë, është vendosur gabim, pasi banesa nuk ka pësuar dëme nga ana ndërtimore dhe nuk duhet të jetë preventivi i dëmeve nga ana ndërtimore.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
3. U miratua më datë 30.06.2020.
4. U shpall me datë 08.07.2020.



SEKRETARI I KËSHILLIT

Emirjan HASMUJAJ

KRYETARI I KËSHILLIT

Ilir HALAJ

